



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 3, pika 3.1, shkronja **b** të Rregullores së UNMIK-ut 2007/30, për ndryshimin e Rregullores 2000/45 mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës dhe të nenit 16, pika 16.1, shkronja **b** të Statutit të Komunës së Prishtinës, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 31.3.2008, merr

V E N D I M

PËR NDRYSHIMIN E DESTINIMIT TË PLANIFIKUAR NË NJË PJESË TË PARCELAVE KADASTRORE NR. 7643 DHE 7644, NË KUADËR TË PLANIT RREGULLUES TË LAGJES "KALABRIA" NË PRISHTINË

Neni 1

Miratohet Vendimi për ndryshimin e destinimit të planifikuar në një pjesë të parcelave kadastrore nr. 7643 dhe 7644, të evidencuara në fletën poseduese nr.10339 në kuadër të Planit rregullues të lagjes "Kalabria" në Prishtinë, të miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës nr.01-35-313, të dt. 24.7.2007.

Neni 2

Pjesëve të parcelave kadastrore nga neni 1 i këtij Vendimi, iu ndërrohet destinimi nga ai ekzistues sipas planit rregullues nga neni 1 i këtij Vendimi, në destinim për ndërtimin e shkollës fillore.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset kryetari i Komunës së Prishtinës. Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe drejtoritë tjera të Komunës së Prishtinës, do të kryejnë veprime nga përgjegjësitë e tyre të caktuara për realizimin e këtij Vendimi.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01.Në 35-375, më 03.04.2008

KRYETARI I KOMUNËS
Prof.dr. Isa Mustafa